



Republika e Kosoves  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti

## PROCESVERBAL

### nga mbledhja e tetë e Komitetit për Komunitete

Është mbajtur mbledhja e VIII e rregullt e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë. Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Srdjan Djuric. Mbledhja është mbajtur në sallën e konferencës në objektin e ri të Komunës së Vitisë, është mbajtur me **24.09.2024** në orën **10h**. Në mbledhje ishin të pranishëm kryesuesi, z.Srdjan Djuric, znj.Kata Pala, znj.Vilsona Maliqi, z.Rifat Aniqi, z.Reshat Azizi dhe përfaqësuesja e OSBE-së, znj.Violeta Mehmeti, zyrtar për Komunitete dhe Kthim, z.Zoran Marinkovic.

**z.Srdjan Djuric:** Mirëdita të gjithëve! Dëshiroj të përshëndes mysafirët nga OSBE, nga UN, kolegët e mi nga komiteti, zotin nënkryetar. Nëse jeni të gatshëm mund të fillojmë. Po hapë mbledhjen e tetë të rregullt të Komitetit për Komunitete me rendin e ditës si në vijim:

### RENDI I DITËS

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Komunitete.**
2. **Diskutim për projekt planin e buxhetit për vitin 2025-2027.**
3. **Të ndryshme.**

**z.Srdjan Djuric:** A pajtoheni me këtë rend dite? Po e vendos në votim rendin e ditës. E konstatoj se rendi i ditës është miratuar dhe mund të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

Pika e parë e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Komunitete**

**z.Srdjan Djuric:** A pajtoheni me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Kush është pro? E konstatoj se procesverbali i mbledhjes së kaluar është miratuar dhe mund të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Duke pasur parasysh se nuk arrita ta caktoj në kohë një pike, për arsye se në momentin e fundit miratuaam këtë pikë të rendit të ditës dhe për disa probleme teknike nuk arritën të më dërgojnë përkthimin, ne u dakorduam që pikën e dytë të rendit të ditës ta udhëheqë zoti nënkryetar, ndërsa unë do të kem përkthimin direkt nga zonjusha Antoneta. I jap fjalën zotit Reshat.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. **Diskutim për project planin e buxhetit për vitin 2025-2027**

**z.Reshat Azizi:** Faleminderit zoti kryesues! Kërkoj falje qe për shkaqe teknike nuk ka mund që kjo pikë të jet e përkthyer në gjuhën serbe. Si pikë e dytë e rendit të ditës kemi mendu të jet plani buxhetor, plani afatmesëm i vitit 2025 – 2027. Dihet që buxheti është një instrument shumë i rëndësishëm i politikës ekonomike për një komunë, sepse në buxhet rregullohen të gjitha të hyrat dhe shpenzimet të cilat kanë me ndodhë mbrenda një viti kalendarik. Korniza afatmesme e një buxheti është planifikus i të hyrave dhe shpenzimet qe synon t'i ketë një komunë. Kanë qenë dy qarkore të kornizes afatmesme buxhetore. Qarkorja e parë ka filluar dikun në maj të vitit 2024, saktësisht me 15 maj jemi njoftu për kufijt fillestar të shpenzimeve e granteve buxhetore të cilat i kemi

parashiku për vitin 2025-2026-2027. Në qarkoren e parë buxhetore të 2025/01 paraqiten udhëzimet e para, siç janë kalendari kohorë, kufiri fillestar i përgatitjes së kornizes afatmesme. Tu e marr parasysht këtë parashikim, nga viti 2024 deri 2027 parashihet një rritje nashti jo fort e kënaqshme, por në krahasim me vitet tjera mujm me thanë se kemi dikun rreth prej 5-8% rritje të buxhetit të komunës. Hargjimet sipas parashikimit të kornizes afatmesme buxhetore, hargjimet më të mëdhaja janë në paga dhe medijtje, ndërsa shpenzime kapitale është si kategori e dytë, ndërsa si kategori e tretë e shpenzimeve janë mallrat dhe shërbimet. Te parashikimet siç e thashë, si ka qenë në krahasim me vitet e kaluara, ta zame në vitin 2023 ka qene 14,996.356.000, ndërsa në vitin 2024 është 16,653,191.00, derisa ne vitin e fundit të kornizes afatmesme buxhetore shihet nje rritje prej 19,696,968.00 është një rritje mesatare dikun prej 5 miliard në krahasim brenda 1 viti. Sa për fillim kaq kisha thane. Nëse ka diksuh diçka?

**z.Srdjan Djurić:** Faleminderit, zotëri, për këtë. Duke pasur parasysht se kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe çështja më e rëndësishme për komunën: a ka ndokush që dëshiron të shtojë diçka në lidhje me këtë, ndonjë replikë?

**z.Reshat Azizi:** I dha vërejtjet e veta Zorani. Ftesën dhe materijalin e kemi marre të premtën, jo sot. Materiali në mënyrë elektronike ka ardh të premtën. Në konsultim, se e kam pa të arsyeshme. Në konsultim me sekretariatit e kuvendit kam kërku që të bëhet si pikë e rendit të ditës parashikimi korniza afatmesme e buxhetit të komunës edhe te shihet te Komiteti për Komunitete. Sekretariati i kuvendit ka thanë e kemi një mangësi që nuk është e përkthyer në gjuhën serbe. Në konsultim me kryesuesin, z.Serdjanin, kam kërku mirëkuptim qe ta mbajmë mbledhjen e Komitetit për Komunitet, po me kusht që me u angazhu të dy, edhe unë edhe Antoneta që ta kem të kuart, edhe kryesuesi e përkrahi plotësisht Zoranin qe thotë, që mungon dikush prej Drejtorisë së Financave. Ka qenë mirë që edhe ata të jenë, por tash sekretariati dhe kryesuesi nashta e kanë parapa, se kjo pikë e rendit të ditës ka kalu përmes kuvendit. E kemi debatuar atje në kuvend, i kemi dhënë vërejtjet dhe sugjerimet të gjitha, si nga ana e pozitës dhe opozites, jo bash në mënyrë amatoreske, që po thotë Zorani për dëgjimet publike, që thotë nëpër fshatra. Në fshatin tim nuk është bërë, do të thotë nuk ka qenë diskriminim kombëtar dikun me shku. Nashti i kanë zgjedh fshatrat ma të mëdhaja, siç është Pozherani, Smira e këto, por dëgjime publike ka pas, kam marrë pjesë edhe unë në sallën e kuvendit të komunës, ka pas dëgjime publike. Fatkeqësisht interesimi është i vogël i qytetarëve. Po e shoh thash që ka rritje prej 2023 dikun rreth 5 miliard e po shpresoj se në qato 5 miliard rritje edhe komiteti, edhe na si Komitet për Komunitete, përfaqësues këtu e kemi naj dobi. Do të thotë pajtona me atë Zoran që, ka qenë dashtë dikush prej Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, ama për këto dëgjimet e këto po të thamë se ka pas dëgjime publike, por interesimi ka qenë i vogël.

**z.Srdjan Djurić:** A ka ndonjë tjetër që dëshiron të shtoj diçka lidhur me këtë? Të jem i sinqert, edhe po të më vinte në gjuhën serbe unë nuk jam ekonomist dhe nuk do të thoja diçka më shumë në këto shifra. Tek e fundit, kemi një muaj kohë për të propozuar që dikush nga financat të vijë. Gjatë këtij muaji mund të bëhet ndoshta përkthimi i plotë. Mendoj se miratimi i kësaj pike do të ndodhë me siguri pas një muaji, apo jo? Mendova se kur ne miratojmë këtë pikë këtu, ne si komitet gjithmonë veprojmë pas një muaji nga mbledhja e kaluar.

**z.Reshat Azizi:** Tash e kemi ne atë premtën me 30 shtator. Kjo pikë nuk miratohet. A për buxhetin për vitin 2025 përfundon me te 30-in. Na e kemi të premtën seancën. Afati ligjor qet muaj përfundon, por unë kisha thanë si njoftim, nëse mundet Antoneta me përkthi këtë që të jet i njoftum Komiteti për Komunitet ka qenë mirë së paku, se çka ka këtu, sa është rritja, çka parashihet, ta kenë si dokument edhe Komiteti për Komunitete.

**znj.Antoneta Palja:** Kryesues, unë sië të thash edhe para se ta fillojmë mbledhjen, e kam kërkuar planin e buxhetit në word document nga drejtoresha e financave, edhe pse nuk ka pas kohë, kam dashtë si shpejt të mundohem t'i përkthej, por nuk më është përgjigj. Pastaj edhe Fatlumi i ka thirrë në telefon Beratin apo kush mirret me këtë punë, dhe ata i kanë thënë që nuk e kemi si document, i kemi të shpërndara dhe nuk ma kanë dërgu.

Ai dokument nuk është 1 faqe dhe nuk ka vetëm tekst, por ka edhe tabela e grafika. Në mënyrë fizike si mi kanë dërgu, më duhet me i ba grafikat prej fillimit dhe kjo me merr shumë kohë si dhe përshkrimi i shifrave. Prandaj e kam kërku si dokument që vetëm tekstin edhe ato tituj t'i përkthej në gjuhën serbe, përndryshe unë nuk e kam vetëm këtë mbledhje me shkru procesverbalin dhe me përkthi, kam edhe dokumente tjera, që nëse ndalem me i ba grafikat dhe tabelat prej fillimit merr kohë edhe dokumentet tjera mbesin. Sa i përket dëgjimit publik nga USAID-it, ndëgjimi publik ka qenë njoftimi në faqen e komunës dhe është mbajtur dje.

**z.Srdjan Djuric:** A ka ndonjë tjetër lidhur me këtë pikë të rendit të ditës? Pra, sa kam kuptuar, kjo është më shumë informuese; ne e marrim këtë, por nuk marrim pjesë në hartimin ose në votimin për komunën.

**z.Reshat Azizi:** Kur të vjen korniza afatmesme e buxhetit, nuk janë të precizume sië kërkoj zonja Violeta, se ta zam ky investim do të bëhet në filan venin. Ta zamë investimet kapitale janë të parapame për vitin 2025. Ka vetëm një list në vija të trasha. Ta zamë asfaltimi i rrugëve nuk shkrun në detaje se ku do te investohet, në cilin fshat është shtruarja e rrugëve me zhavorr. Këte vërejtje e kemi pas edhe në kuvend, që nuk janë të precizume amo unë nuk po e shoh që është krejt terr qysh po thotë Zorani, se në kuadër të asfaltimit të rrugëve aty mundet me hi edhe rrugët e fshatrave ku jetojne komunitetet. Ta zam janë të parapame kaq për rregullimin e trotuareve, nuk është e precizume a trotuari në Kabash a trotuari në Binçë a ku. Do të thotë janë në vija të trasha, nuk mujmë na me precizu aty se cilat në kuadër të qatyne trotuareve. Na ta zam në çdo seancë të Komitetit për Komunitete kemi kërku një zgjidhje të bahet për rrugën prej qendres Binçës deri te shkolla, se me të vërtet është rrugë e rrezikshem, janë të rrezikum nxënësit. Për fillim kemi kërku ato pengesat horizontale, une e shohë që ato janë realizu për çështjen e trotuarit që një vit e ngritmi zanin që të rregullohet trotuari në Binçë, por seriozisht tash është angazhu kryetari edhe drejtori kanë dal po ka pengesa teknike ose duhet të rregullohet naj qysh çashtja e rrugëve, se ngushtohet rruga nëse rregullohet trotuari, se ato ose jane prona private ose diçka ka, se aty me të vërtet është problem i madh. Na mujmë me insistu prapë në këto rregullime që na ka premtu kryetari në kuader të rregullimit të trotuareve të ketë orientim edhe në vendet ku jetojnë komunitetet. Unë si person ka me insistu edhe përhere po insistoj, që sidomos rruga që është kërku edhe nga kryesuesi i mëhershëm. Kjo ka qenë kërkesë e përhershme e te ndjerit dhe unë ka me kërku përhere derisa të realizohet, se kjo është detyrë qysh me thanë si ndjenj, si obligim moral e atij që e ka kërku përhere. Kjo mundet me u ba në kuadër të këtyre investimeve qe po i cekum në buxhet që nuk janë të precizume.

**z.Srdjan Djuric:** Po planifikoj që në pikën e ardhshme të rendit të ditës të përfshijë këtë për ta ripërsëritur. Para disa ditësh isha atje, dhe as si këmbësor nuk mund të kalosh më lart; të paktën duhet të bëhet ndonjë adaptim, sepse dje isha dhe nuk mund të ecja më, thjesht është siç është, uji ka marrë gjithçka. Megjithatë, nuk është një distancë e madhe, ndoshta 200-250 metra, ndoshta edhe më pak, rruga ekziston, thjesht duhet të adaptohet dhe të rregullohen tubat për ujë.

**z.Reshat Azizi:** Aty tek shkolla kemi kërku edhe në kuvend. Sipas drejtorit do te vendosen vija vibruese. Na në kuvend kemi kërku që aty të bëhet një rreth rrotullim, shpetimi me i madh aty ka qene një rrethrotullim, nëse ka kushte, se me të vërtetë pjesa ma e rrezikshme e qytetit është aty. Është bë rruga dykajshe, sa ka qenë njëkajshe ka qenë rreziku më i vogël, është i qelur një market aty që e shton rrezikun edhe më të madh, është udhëkryeqi që vjen prej shkollës së mesme prapë rrezik i madh është aty, vjen rruga që lidhë Binçë – Beguncë – Letniëc, qaty kryqëzohen rruga përmes qytetit. Vendi ma i rrezikshëm në Viti është ai. Do të thotë nëse mundet një rrethrotullim aty ka qenë shpëtimi më i mirë. Nuk mundemi na këtu me dhanë propozime, kuvendi e miraton buxhetin, mirëpo na mundemi të kërkojmë për aprovim në kuadër të drejtorisë përkatëse që të intervenoj në ato vende ku kërkon Komiteti për Komunitete. Te investimet kapitale, ta zam investimet kapitale të bahen trotuari ne filan veni ose te rregullohet rruga që po e kërkoj unë vazhdimisht prej qendres deri tek varrezat nalt, se keto janë nënpika te investimeve kapitale që nuk janë të precizume, se do të bahen filan rruga, filan trotuari, por janë të specifikume në asfaltim kaq, në rrugë me zhavorr, trotuare. Gjitha këto janë në vija të trasha atë precizume, mirëpo

në kuadër të atyre na mundemi me kembngul me insistu për një investim që neve na konvenon, se unë nuk besoj që mundemi me ndiku në rritjen e buxhetit, a në shperndarjen e buxhetit te investimet kapitale na mujm me ndiku ketu. Na sa here qe na është dhanë rasti na kemi kërku që me shkrim te rekomandohet. Me shkrim na është vërtetu që është ba kërkesa te drejtoria përkatëse, që është ba kërkesa pikërisht e ketij Komitetit për Komunitete, e tash sa është realize mu ma merr mendja se 80% e kërkesave tona janë realizu, mirëpo detyrë prioritare e jona është që përhere të kërkojmë jo në përshkrimin e buxhetit, po në çdo seancë të kërkojmë që prej investimeve kapitale një pjesë e investimeve kapitale të shkoj në lokalitetet ku janë komunitetet. Prapë po kthehem te pika e buxhetit. znj.Vilsona dhe unë jemi ura lidhëse në mes kuvendit dhe komitetit. Nëse jeni të mendimit, na bajmë lista përhere edhe e paraqesim shqetësimin në kuvend. Kërkojmë ta zamë rregullimin e trotuarit, rrugës, por na kemi mendu se metoda të cilën e kemi apliku që kërkesa drejtpërsëdrejti ti shkoj kryetarit dhe drejtorisë përkatëse. Nashta ka qenë me efikase, se na mujm edhe në kuvend që ta bëjmë paraqitjen ose në baza mujore qysh i majm seancat, se zakonisht 1 javë para se të mbahet seanca e kuvendit, mbahet seanca e Komitetit për Komunitete, mirëpo ose bajmë qysh po thotë Zorani listën vjetore të kërkesave ose mujm për çdo seancë çdo kërkesë ta paraqesim në kuvend. Kemi dy përfaqësues, znj.Vilsona na mujm me ngritë përhere çdo kërkesë të komitetit ta ngritmi zanin edhe në kuvend. Është mangësi e jona se na e kemi ba rekomandimin, e kemi pa që rekomandimi ka shku a interesimi i komitetit ka qenë jo bash totalisht, por pak i zbehtë, p.sh. kemi kërku, unë kam insistu disa here te shihet se ku kanë mrrri me ndriçimin e rrugëve qe i ka kërku z.Rifat. Kam kërku ku ka mrrri çashtja me ndihmat humanitare për komunitetin kroat. Kam kërku për zonën që thash është e rrezikshme ku ka mrrri çështja e sinjalizimit horizontal, po nuk kam kërku, p.sh.: ku ka mrrri puna me rregullimin e rrugës për tek varrezat. Këtë e pranoj që nuk e kam kërku. Këtu e kemi ngritë zanin e atje s'kam kërku se ku ka mrrri, a është planifiku diçka a jo, do të thotë prapë se prapë është në qalim.

**z.Srdjan Djuric:** A ka ndonjë tjetër që dëshiron të shtojë diçka për këtë pikë? Atëherë, kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, të ndryshme.

Pika e tretë e rendit të ditës:

### **3. Të ndryshme**

A ka ndonjë propozim ose ndonjë gjë këtu?

**z.Reshat Azizi:** Te kjo pikë veç si informat, se kryetari na tha se i ka ndihmu komunitetit kroat me ndriçim dhe me pako. Tash mundet me na informu Kata, nashti është me në rrjedh, a është me të vërtet a ka shtu diçka.

**znj.Kata Palja:** Unë kam informata që, 375 kg miell apo 15 thasë nga 25kg i ka dergu te motrat e nderit, që atje ta përgatisin bukën dhe ta shperndajnë tek këta persona, sepse ata as nuk kanë kushte e as nuk janë në gjendje ta përgatisin, sepse janë të moshuar. Kryetari ka dashur edhe më shumë t'u dërgoj, por për shkak që nuk kanë hapësirë se ku ta ruajnë, ju ka dërgu kaq dhe që do vazhdoj vazhdimisht të dërgoj kur kanë nevojë. Sa i përket ndriçimit, kryetari ka thënë që, së bashku me drejtorin e shërbimeve publike do ta shqyrtojnë, por a është realizume nuk e di.

**z.Reshat Azizi:** Me rrugën tane çka u ba rifat, a u rregullu?

**z.Rifat Aniqi:** Po, ndriçimin e kanë rregullu, vetëm se cenzorin e kanë lanë nja 2 orë ma vonë po dhezen dritat.

**z.Srdjan Djuric:** A ka ndonjë tjetër që dëshiron të shtojë diçka? Pra, nuk ka asgjë. Faleminderit mysafirëve nga UNMIK-u dhe gjithashtu OSBE-së. Mendoj se mund ta mbyllim këtë mbledhje deri në caktimin e ardhshëm

Mbledhja përfundoj në 11:17 min

**Procesmbajtes:**  
**znj.Antoneta Palja**

**Kryesuesi i Komitetit për Komunitete**  
**z.Srdjan Djuric**